



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E KORÇËS

Korçë, më datë 15/10/2019

Proces-verbal nr. 1

Bazuar në LIGJIN Nr 139/ 2015, neni 3, pika “dh”, në datën 14 tetor 2019 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të banorëve, u zhvillua takimi me banorët e qytetit të Bashkisë Korçë.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, z. Ilir Dinellari Drejtor I NSHP, z. Leonard Gjançi Dr. i Menaxhimit të Kontratave dhe znj. Eugerta Vani Përgjegjëse e Drejtorisë së Tarifave dhe Taksave Vendore.

Të pranishëm në takim ishin banorë nga të gjitha lagjet e qytetit të Korçës.

Fjalën e mori i pari z. Sotiraq Filo, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara por edhe në proces në qytetin e Korçës dhe Njësitë Administrative. Mes tyre përmendi projektet e përqëndruara tek infrastruktura bazë duke u përqëndruar tek Paketa e rrugëve e cila parashikoi ndërhyrje në lagjet 4,5,6,8 dhe 13 të qytetit. Projekte të tjera të rëndësishme të përfunduara apo edhe në vazhdim që u përmendën nga Kryetari i Bashkisë Korçë ishin : Markata e re e Korçës, Qyteza e Fëmijëve, zona Sportive, Biblioteka e Re, Qendra e artit dhe Kulturës, Rikonstruksioni i shkollave në qytet dhe fshatra, Çerdhja e re, Apartamentet Sociale, Rikonstruksioni i Lulishtes “Shën Maria”, etj. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të qytetarëve dhe vendosjen e prioriteteve për investimet pasi impakti i parë i çdo projekti perceptohet prej tyre.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me pjesëmarrje”, qytetarët e Korçës patën hapësirën e nevojshme kohore për të ngritur kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2020. Kërkesat e tyre u mbajtën

shënim paralelisht dhe të detajuara. Bazuar në kërkesat e ngritura nga qytetarët u listuan prioritetet si më poshtë:

XXX: Jam nxënës i shkollës së mesme dhe do të doja të dija cilat janë projektet për të rinjtë. A do të bëhet realitet projekti I teknologjisë së Informacionit. Me aq sa e kam dëgjuar është një project që krijon shumë hapësira për të rinjtë dhe do të doja që për të të kishte një fond të dedikuar në buxhetin e bashkisë.

XXX: Bashkia duhet të zgjidhë problemin e heqjes së disa barakave që ndodhen mes shkollës së Maltës dhe Universitetit. Janë shqetësim pasi mbahen edhe kafshë nga njerëzit që jetojnë aty.

XXX: Problem mbeten pallatet e amortizuara. Si do të zgjidhet ky problem pasi mes banorëve është e vështirë të gjendet komunikimi.

XXX: Jam banor I lagjes 16 të qytetit. Në pallatin tonë tarraca pikon, ambientet e përbashkëta nuk mirëmbahen nga banorët ndërsa pjesa e suvasë së jashtme po bie nga lagështia. Cila do të jetë zgjidhja pasi në dijenin time është problem kudo. A ka buxhet nga bashkia për këtë çështje?

XXX: Jam banore e lagjes 9 por dua të ngre disa shqetësime jo vetëm për zonën ku banjo. Së pari në lagjen 9, pallati në krah tek lulishte “Shën Maria” ka një problem me ujërat e zeza si edhe prezencën e një biznesi fastfood që na shkakton ndotje. Lutemi të merrni masa. Së dyti, tek zona e policisë së vjetër, siç I themi ne ka disa rrugë ku kalldrëmi është dëmtuar. Mund të ketë edhe të tjera në qytet por mua aty më bie rryga. A mund të parashikohet në buxhet një fond për sistemimin e tyre? Së treti, Bashkia e Korçës a do të japë një kompensim për familjet e dëmtuara nga tërmeti?

XXX: Në lagjen 10 tek blloku i ri i Entit të Banesave a do të bëhet sistemim i rrugës, asfaltim, trotuarë, ndriçim e lulishte për ta bërë edhe këtë zonë si gjithë të tjerat? Keni menduar të parashikoni një ndërhyrje të tillë?

XXX: Në zonën e SMT u bënë disa ndërhyrje, asfaltime rrugësh, trotuarë etj. Duke qenë se zona është shumë e gjerë, ka shumë rrugë, biznese etj, a do të vazhdojnë këtë vit punimet për pjesën e mbetur

XXX: Zoti kryetar, unë dua të ndalem pak tek shkolla “Demokracia”. Tek sheshi gjykoj se ka më shumë nevojë për gjelbërim, palestra duhet sistemuar, shkolla ka nevojë për një suvatim të ri, termoizolim gjithashtu etj.

XXX: Cilat do të jenë politikat tuaja për rritjen e punësimit dhe tërheqjen e investitorëve? Prej kohësh flitet për një fabrikë përpunimi të prodhimeve bujqësore të zonës, kur do të realizohet?

